



3

C.nr.737 /15

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Gjyqtari Msc.Fatmir Baloku në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Agjensia e Kosovës për mbrojtjen e Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari nga Avokaturës Shtetërore Shefqet Hasimi nga Prishtina, kundër të paditurit Dardan Lajqi nga fshati Shtupeq i Vogël, Komuna e Pejës për kompensim të dëmit, vlera e kontestit **493.50 Euro**, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të datës 16.02.2017. jasht seancës me dt.23.02.2017 bjen këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET i padituri Dardan (Isuf) Lajqi me banim ne fshatin Shtupeq i Vogël-KK. Pejë që shumën prej **493.50 Euro** (katërqind e nëntëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent), ti kthej në llogarinë e paditësës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor nr.l xhirollogarisë 1000400070000180 në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përfundimit me forcë.

Secila nga palët i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Arsyetim

Paditësi me padinë e parashtruar me datë 26.08.2015 ka theksuar siq vijon:

I padituri me datën 11.08.2014 rreth orës 20:45 min, në rrugën Pejë-Rugovë, kilometri i tretë, pjesë e territorit kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’ në të cilin ndalohet shfrytëzimi i të mirave të natyrës, është hasur gjatë patrollimit të policisë kufitare, duke transportuar masën drusore trupa teknik të llojit breut, me automjetin transportues me targa **03-973-DD**, të pa damkosura dhe pa fletëpërcjellëse me ç’rast ka shkaktuar dëm në vlerë prej **493.50 Euro(1.41x350)**, kalkuluar dhe bazuar në tabelën numër një të çmimorës për kompenzimin e dëmeve.

Lidhur me këtë Gjykata Themelore Departamenti i Përgjithshëm Divizioni i Kundërvajtjes në Pejë, të paditurin në fjalë e kishte shpallur përgjegjës për kundërvajtje të kryer nga neni **166 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr 03/L233** për mbrojtjen e natyrës.

I autorizuari i paditësit ne fjalën e tij përfundimtare në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16.02.2017 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë , edhe pas dëgjimit te dëshmitarit ku u vërtetua bindshëm baza e padisë dhe e kërkesëpadisë andaj gjykatës i propozojë që të aprovohet ne tërësi si e bazuar padia duke e detyruar te paditurin qe vlerën prej **493.50 euro** ti kthej ne llogarinë rrjedhëse Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, llogaria rrjedhëse gjendet ne shkresa te lëndes, me numër **1000400070000180**.

Gjykata fillimisht të paditurit i ka dërguar aktvendimin për dhenien e përgjegjës në padi së bashku me padi dhe provat e tjera të dorëzuara nga paditësja e të cilat i njëjti i ka pranuar me datën 19.02.2016, por i njëjti nuk ka dorëzuar përgjigje në padi.

I padituri gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë të datës 16.02.2017 dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se edhe me tejë e konteston padinë dhe kërkesën e saj për shkak se masën drunore që e ka pasur të ngarkuar e ka marrë në pyllin e tij e jo në atë shoqëror, ai gjithashtu deklaroi se kam pyll timin privat e vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit Haxhi Muriqi ku i cili gjatë dëgjimit të tij nuk mundi të dëshmojë se kjo masë drunore është marrë në pronën shoqërore por është konfiskuar për shkak se nuk ka qenë e damkosur.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë nxjerrjen e këtyre provave:

Është shikuar fletëparaqitja e rojtarit të natyrës së parkut kombëtar datë 20.08.2014

Është lexuar procesverbali mbi konfiskimin e sortimenteve pyjore të datës 18.08.2014

Është shikuar shkresa-forma e pranimit-dorëzimit të lendës së rastit datë 18.08.2014

Është shikuar raporti fillestar i incidentit datë 11.08.2014

Është lexuar deklarata e të dyshuarit me datë 11.08.2014

Është shikuar dëftesa mbi konfiskimin e pronës datë 11.08.2014

Është shikuar fletëparaqitja për kundërvajtje si dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni i Kundërvajtjes **Nr-3 regj-12860/14 i** datës 30.12.2014 Janë shikuar fotot e vendit të ngjarjes.

Si dhe është bërë dëgjimi i dëshmitarit Haxhi Muriqi i cili gjatë seancës ka deklaruar, se edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë nga dita kur ka ndodhur ky rast pra me datë 30.12.2014 më kujtohet kjo çështje sepse të paditurin ka qenë hera e parë që e kemi zenë me masë drusore të llojit të breut e të cilat ia kemi konfiskuar pasi që nuk kanë qenë të damkosur dhe as nuk ka pasë lletë përcjellëse për transport.

Pas vlerësimit të provave veç e veç e të gjitha në lidhshmëri reciproke e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vërtetojë këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se me datën 30.12.2014 këtu të paditurit i është konfiskuar masa drunore e llojit të breut me vëllim 1.41 m³, të cilën e transportonte këtu i padituri me automjetin transportues me targa **03-973-DD** të pa dëmkosura dhe pa lletëpërcjellëse.

Gjithashtu në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kotnestues fakti se për këtë këtu i a padituri është shpallur përgjegjës nga Gjykata Themelore Pejë divizioni i kundërvajtjes dhe për këtë i është shqiptuar masa dënimi me gjobë prej 300 Euro, si dhe është caktuar masa mbrojtëse marrja e sendit-KONFISKIMI i masës drusore me vëllim prej 1.41m³.

Në mes të palëve ndërgjyqëse është kontestuese se këtë masë drusore i padituri a e ka marrë në pyllin e tij po në pyllin shoqëror.

Gjykata në rastin konkret përmes dëshmitarit Haxhi Muriqi i cili punon si pylltar, ka vërtetuar se në çdo rast kur ndonjë transportues duhet të bartë masë drunore si në pronën shoqërore ashtu edhe në pronën private së pari behët damkosja e masës drunore dhe njëkohësisht lëshohet letra përcjellëse për transport.

Të njëjtit dëshmitar gjykata ja falë besimin e plotë sepse i njëjti ishte mjaftë bindës dhe në mënyrë shumë profesionale i sqaroi gjykatës mënyrën se si rrjedhë procedura për marrjen e masës drunore si në pronën shoqërore poashtu edhe në atë private.

Sipas dispozitave të nenit 7 par.1 i LPK-së palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Ndërsa sipas nenit 319 par.1. i LPK-së secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyre te provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në rastin konkret pala paditëse me provat e propozuara dhe të administruara gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka bindë gjykatën se i padituri i ka shkaktuar dëmin e pretenduar nga paditësja , ndërsa i padituri me asnjë provë nuk ka mundë ta bindë gjykatën që masa drunore që i është konfiskuar është prerë në pronën e tij private sepse i njejti qysh më parë ka ditur se para se të merret masa drunore e njejta duhet të damkoset nga personi zyrtar si dhe nga i njejti të merret fletë-lëshimi sepse i njejti nuk ka qenë hera e parë që ka transportuar masë drunore.

Sipas nenit 169 të LMD-së shpërblimi i dëmit material (Kompensimi) mundë të behët me vendosjen e gjendjës që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit ose me të holla.

Varësisht nga rasti, ekziston mundësia që këto dy mënyra të kompensimit të dëmit të gjejnë zbatim të përbashkët (Kumulativ).

Në par.1 të nenit 169 të LMD-së është parashikuar detyrimi i personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, me qëllim të kompensimit të atij dëmi.

Sipas kësaj dispozite ligjore, rregull me përparësi për kompensimin e dëmit material është vendosja e gjendjës që ka qenë para shkaktimit të dëmit, para shpërblimit në të holla.

Menyre e vendosjes së kësaj rregulle është në favor të palës së demtuar pasi që ajo mundë të heqë dorë nga kjo formë dhe menyrë e kompensimit të demit material dhe të kërkojë kompensimin në të holla edhe ne raste kur është e mundur kompensimi natyror.

Pasi që në rastin konkret nuk është e mundur rivendosja e gjendjës së mëparshme gjykata vendosi që ta detyrojë të paditurin që paditëses të ja kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën e cekur në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoj edhe provat e tjera të administruara por të njejtat nuk ishin me rendësi për vendosje ndryshe në këtë çeshtje juridike civile-kontestimore.

Gjykata vendosi që secila nga palët ti bartë shpenzimet e veta të procedurës pasi që paditësja nuk kërkoj shpenzimet e procedurës.

Prandaj nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Pejë me dt.23.02.2017



**Gjyqtari
Fatmir Baloku**

Udhëzim Juridik

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 7-ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

Ankesa i dorëzohët Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore në Pejë.